



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË

DISERTACION

I

PARAQITUR NGA

Zj. ANITA KRRASHI

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

SPECIALITETI: NEFROLOGJI

**TEMA: MUNDËSITË E APLIKIMIT TË PARAMETRAVE BIOLOGJIKË MË
SENSITIVË NË NDJEKJEN E PATOLOGJIVE RENALE KRONIKE NË KUSHTE
TË REGJIMIT HYPOPROTEINIK**

Udhëheqës Shkencor: Prof. As. Zheni Gjergji

TIRANË 2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË

DISERTACION

I

PARAQITUR NGA

Z. ANITA KRRASHI

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

DOKTOR

SPECIALITETI: NEFROLOGJI

**TEMA: MUNDËSITË E APLIKIMIT TË PARAMETRAVE BIOLOGJIKË MË
SENSITIVË NË NDJEKJEN E PATOLOGJIVE RENALE KRONIKE NË KUSHTE
TË REGJIMIT HYPOPROTEINIK**

Udhëheqës Shkencor: Prof. As. Zheni Gjergji

MBROHET ME DATË/...../2023

PARA JUSISË

1. PROF. VERA OSTRENI

KRYETAR

2. PROF. MEHDI ALIMEHMETI

ANËTAR (OPONENT)

3. PROF. ASC. MAJLINDA KOKICI

ANËTAR (OPONENT)

4. PROF. ALMA IDRIZI

ANËTAR

5. PROF. LEDJAN MALAJ

ANËTAR

TIRANË 2022

FALENDERIME DHE MIRËNJOHJE

Falenderime për kolegët e Shërbimit të Nefrologjisë në QSUT “Nënë Terza”, ku jam formuar profesionalisht, dhe kolegët e Spitalit Rajonal të Durrësit për bashkëpunimin e deritanishëm.

Mirënjohje për përkrahjen gjatë punës për realizimin dhe finalizimin e doktoraturës, dijet mjekësore dhe vlerat njerëzore Prof. Dr. Alma Idrizi, Prof. Margarita Gjata, Prof. Enver Roshi, Prof. As. Zheni Gjergji.

Dedikuar familjes sime!

Përmbledhje

MUNDËSITË E APLIKIMIT TË PARAMETRAVE BIOLOGJIKË MË SENSITIVË NË NDJEKJEN E PATOLOGJIVE RENALE KRONIKE NË KUSHTE TË REGJIMIT HYPOPROTEINIK

Hyrje. Matja e parametrave biologjikë është e rëndësishme jo vetëm në diagnostikimin e pacientëve me Sëmundje Renale Kronike (SRK), por edhe në monitorimin dhe ndjekjen e tyre. Ky monitorim është edhe më i rëndësishëm në pacientët me SRK që ndjekin një dietë hypoproteinike. Veshkat janë organi kryesor që bën degradimin e produkteve të proteinave.

Dieta me përmbajtje të ulët proteine është përdorur për trajtimin e pacientëve me sëmundje renale kronike. Një numër i madh kombinimesh të dietës të varfër në proteina të shoqëruar me ketoanalogë janë testuar duke çuar në rezultate kontradiktore. Dy meta-analiza treguan se një dietë me përmbajtje të ulët proteinash e shoqëruar me ketoanalogë ishte efektive në uljen e niveleve të proteinurisë, sklerozës glomerulare dhe fibrozës renale.

Qëllimi i studimit. Vlerësimi i efikasitetit të dietës me përmbajtje të vogël proteinash dhe e shoqëruar me suplemente ketoanalogë (KA) në funksionin dhe morfologjinë renale si dhe në parandalimin e progresionit të sëmundjes renale kronike stadi 3 dhe 4.

Pacientët dhe metodat. Në studim janë përfshirë 120 pacientë të ndarë në 3 grupe:

1. dietë me përmbajtje shumë të ulët proteinash (0.6 g/kg/peshë/ditë) shoqëruar me KA;
2. dietë me përmbajtje të ulët proteinash (0.8 g/kg/peshë/ditë) shoqëruar me KA;
3. dietë me përmbajtje relativisht të ulët proteinash (1.2 g/kg/peshë/ditë).

Rezultatet. U konstatua një ulje të vlerës mesatare të BMI në Gr I, që merrnin KA, ndërsa ulja nuk ishte statistikisht sinjifikante në grupet e tjera. Vlerat mesatare të proteinurisë 24 orëshe pësuan një rënie të vazhdueshme përgjatë tremujorëve në të tre grupet. Vlerat mesatare të proteinemisë pësuan një rritje të lehtë pas 6, 9 dhe 12 muajsh. Rritja e vlerës mesatare të proteinemisë ishte statistikisht më e lartë në GR II krahasuar me Gr I. Vlera mesatare e klirensit të kreatinës u rrit në të tre grupet.

Konkluzion. Ketoanalogët ofrojnë aminoacide jo të dëmshme për të parandaluar kequshqyerjen në pacientën me SRK.

Fjalët kyç: Sëmundje Renale Kronike, Dietë hipoproteinike, Ketoanalogë, Klirensi i kreatinës, Proteinuria

Abstract

POSSIBILITIES OF APPLICATION OF MORE SENSITIVE BIOLOGICAL PARAMETERS IN THE FOLLOW-UP OF CHRONIC RENAL PATHOLOGIES UNDER CONDITIONS OF HYPOPROTEIN REGIME

Introduction. The measurement of biological parameters is important not only in the diagnosis of patients with Chronic Kidney Disease (CKD), but also in their monitoring and follow-up. This monitoring is even more important in patients with CKD who follow a hypoprotein diet. The kidneys are the main organ that degrades protein products. Low-protein diets have been used to treat patients with chronic kidney disease. A large number of combinations of low-protein diet combined with ketoanalogues have been tested leading to conflicting results. Two meta-analyses showed that a low-protein diet combined with ketoanalogues was effective in reducing levels of proteinuria, glomerular sclerosis and renal fibrosis.

Aim of the study. Evaluation of the efficacy of a low-protein diet combined with keto-amino acid supplements on renal function and morphology and in preventing the progression of stage 3 and 4 chronic kidney disease.

Patients and methods. The study included 120 patients divided into 3 groups:

1. diet with very low protein content (0.6 g/kg/weight/day) accompanied by ketoanalogs;
2. diet with low protein content (0.8 g/kg/weight/day) accompanied by ketoanalogs;
3. diet with relatively low protein content (1.2 g/kg/weight/day).

Results. A decrease in the mean value of BMI was found in Group I, receiving ketoanalogs, while the decrease was not statistically significant in the other groups. Mean 24-hour proteinuria values declined steadily across trimesters in all three groups. Mean proteinemia values increased slightly after 6, 9, and 12 months. The increase in the mean value of proteinemia was statistically higher in GR II compared to Gr I. The mean value of creatinine clearance increased in all three groups.

Conclusion. Keto-analogs provide non-harmful amino acids to prevent malnutrition in the CKD patient.

Key words: Chronic Kidney Disease, Low-protein diet, Ketoanalogs, Creatinine clearance, Proteinuria

PËRMBAJTJA

LISTA E AKRONIMEVE.....	7
1.HYRJE.....	8
1.1 Sëmundja Renale Kronike (SRK).....	8
1.2 Epidemiologjia e SRK.....	9
1.3 Parametrat biologjikë në ndjekjen e të sëmurëve me SRK	10
1.4 Përdorimi i ketoanalogëve në trajtimin e SRK	12
1.5 Historia e përdorimit të ketoanalogëve në SRK.....	12
2. Qëllimi.....	14
3. Objektivat specifike.....	14
4.METODOLOGJIA.....	15
4.1 Tipi i studimit.....	15
4.2 Popullata në studim.....	15
4.3 Mbledhja e të dhënave	16
4.4 Analiza statistikore.....	20
5. REZULTATET.....	22
5.1 Analizimi i të dhënave të përgjithshme	22
5.2 Analizimi i matjeve të përsëritura të parametrave laboratorikë.....	26
6. DISKUTIMI.....	63
7. PËRFUNDIMET.....	66
8. REKOMANDIMET.....	68
 KUFIZIMET E STUDIMIT.....	 69
 BIBLIOGRAFIA.....	 70

LISTA E AKRONIMEVE

SRK: Sëmundje renale kronike

ICRSV: Iniciativa për cilësinë e rezultateve të sëmundjes së veshkave (në ang: KDOQI= Kidney Disease Quality Outcome Initiative)

FG: Filtrimi glomerular (në ang: GRF= glomerular filtration rate)

KA: Ketoanalogë

DPUP: Dietë me përmbajtje relativisht të ulët proteinash (1.2 g/kg/peshë/ditë) (në angl: LPD= low protein diet)

DPSUP: Dietë me përmbajtje shumë të ulët proteinash (0.6 g/kg/peshë/ditë) (në ang: VLPD= very low protein diet)

IMT: Indeksi i masës trupore (në ang: BMI= body mass index)

TG: Trigliceridet

Hb: Hemoglobina

HTA: Hipertension arterial

KSK/OZNY: Klasifikimi i stadi të katërt të sëmundjes së zemrës sipas Organizatës së zemrës Neë York (në ang: NYHA IV= Neë York Heart Association IV)

PNK: Pielonefriti Kronik

ISD- Indeksi socio-demografik (në ang: SDI-Socio-demographic Index)

PTH- Hormoni i paratiroides

DALY -Disability adjusted life years (cilësia e jetës)

1. HYRJE

1.1 Sëmundja Renale Kronike

Sëmundja Renale Kronike (SRK) sipas Kidney Disease Quality Outcome Initiative (K/DOQI) përkufizohet si:

1. Dëmtimi i veshkës për 3 ose më shumë muaj, që vjen nga abnormalitete strukturore ose funksionale të veshkës, i shoqëruar ose jo me ulje të nivelit të filtrimit glomerular (FG) e që manifestohet me të paktën:

-abnormalitete patologjike ose

-markues të dëmtimit renal duke përfshirë abnormalitete në përmbajtjen e gjakut ose urinës ose abnormalitete në testet radiologjike.

2. $FG < 60 \text{ mL/min/1.73 m}^2$ për ≥ 3 muaj e shoqëruar ose jo me dëmtim të veshkave (1-3)

SRK karakterizohet nga një humbje progressive e strukturës dhe ose funksionit të veshkës.

Dëmtimi i veshkës në SRK ndodh si pasojë e dy mekanizmave: një mekanizëm iniciues dhe një mekanizëm që përkeqëson gjendjen aktuale. Një stimul iniciues mund të jetë një problem ekzistues i veshkës (mund të jetë anormali ose e dëmtuar gjatë rrugës), një shkak inflamator ose i ndërmjetësuar nga sistemi imun, ose një sulm toksik. Ky dëmtim përkeqësohet nga procesi i hiperfiltrimit dhe hipertrofisë së nefroneve të mbetura. Kjo mund të shkaktohet nga disa mënyra ose rrugë si hormone (sistemi reninë-aldosteron), citokinat dhe faktorët e rritjes. Ky proces shkakton një rritje të presionit në nefrone si pasojë e mbushjes së arterieve, duke shkaktuar kështu ndryshime në strukturën e tyre si dhe ndryshime të podociteve duke rezultuar në dëmtim të sistemit të filtrimit. Për rrjedhojë këto sulme të vazhdueshme cojnë në sklerozë të nefroneve dhe në rënien progresive të funksionit renal që pasqyrohet me ulje të nivelit të FG (4, 5). Si pasojë shfaqen crregullime metabolike si hiperfosfatemia, uremia, albuminuria etj.

Shkaktarët kryesorë të SRK përfshijnë diabetin dhe hipertensionin (6). Ndër shkaktarë të tjerë janë edhe glomerulonefriti dhe pielonefriti. Gjithashtu faktorë të tjerë si obeziteti, duhanpirja, alkooli kontribuojnë si në shfaqjen por edhe në progresionin e sëmundjes kronike të veshkave (7, 8). SRK kategorizohet në 5 stade bazuar në shkallën e FG (Tabela 1) (9, 2, 6, 10). Ka disa teste dhe parametra tregues të funksionit të veshkave por FG konsiderohet si treguesi më i mirë (6, 9).

Tabela 1. Stadet e SRK

STADI	PËRSHKRIMI	FG (ml/min/1.73 m²)
I	Dëmtim renal me FG normal ose të rritur	<90
II	Dëmtim renal me ulje të lehtë të FG	60-89
III	Dëmtim mesatar i veshkës më ulje të moderuar të FG	30-59
IV	Dëmtim i rënde i veshkës më ulje të rëndë të FG	15-29
V	Insuficencë renale	< 15 (ose dializë)

Bazuar në nivelet e albuminurisë SRK ndahet në kategoritë që tregohen në Tabelën 2 (6).

Tabela 2. Kategoritë e SRK sipas albuminurisë

Kategoria	Albuminuria 24 orëshe (mg/24h)	Raporti Albuminë/Creatininë mg/g	Klasifikimi
A1	<30	<30	Normale
A2	30-300	30-300	E moderuar
A3	>300	>300	E rëndë

Një tregues tjetër i funksionit të veshkave është niveli i kreatininës në gjak. Nëse funksioni i veshkave ngadalësohet, niveli i kreatininës rritet.

1.2 Epidemiologjia e SRK

Rritja e shpejtë e popullsisë, plakja e popullsisë dhe ndryshime të tjera në trendet epidemiologjike po ndryshojnë epidemiologjinë e SRK në mbarë botën. Rritja e numrit të pacientëve me diabet dhe hipertension si dy nga shkaqet kryesorë të SRK ka çuar në rritje të numrit të pacientëve (11-14). Sipas një studimi nga Xie et al. nga viti 1990 në vitin 2016 në mbarë botën incidenca e SRK u rrit me 89%, prevalenca u rrit me 87% dhe barra e sëmundjes u rrit me 62% (11). Shifrat vazhdojnë të rriten progresivisht dhe SRK vazhdon të jetë një problem i shëndetit publik në mbarë botën (15). SRK është sot një sëmundje prevalente në popullatën adulte që prek >10% (8-16%) të popullatës në mbarë globin, specifikisht >800

milion individë (16, 17). Prek më së shumti individët e moshuar, femrat, minoritetet racore dhe individë që vuajnë nga hipertensioni dhe diabeti (18).

Rezultatet e një review sistematike në 2010 e cila përfshiu 33 studime, treguan se prevalenca globale e SRK stadi I-IV ishte 10.4% për meshkujt të moshës ≥ 20 vjec dhe 11.8% për femrat e po të njëjtës grupmoshë (19). Të shpërndara sipas vendeve me të ardhura të ulta apo të mesme apo të larta si më poshtë: 8.6% e meshkujve dhe 9.6% e femrave në vendet me të ardhura të larta dhe 10.6% e meshkujve dhe 12.5% e femrave në vendet me të ardhura të mesme në të ulta (19). Në Shqipëri të dhënat mbi epidemiologjinë e SRK sidomos pas viteve të pandemisë nuk janë të përditësuara. Sipas raportit vjetor 2019 të Organizatës Europiane Renale (ERA), në Shqipëri incidenca e SRK është 138 individë për 100 milion banorë (20). SRK është një ndër shkaktarët kryesore të vdekjeve në botë dhe është pjesë e një numër të vogël sëmundjesh jo të komunikueshme që po tregojnë një rritje të shkallës së vdekshmërisë në dy dekadat e fundit (18). Sëmundja Renale Kronike renditet si shkak i 16, i humbjes së cilësisë së jetës (DALY- disability adjusted life years) në botë (9). Sipas një studimi mbi barrën globale të SRK në vitin 2017, shkalla e vdekshmërisë nga SRK në të gjitha grupmoshat u rrit me 41.5% krahasur me vitin 1990 (21). Paraqet një barrë të madhe financiare për vendet me të ardhura të ulta apo të mesme të cilat nuk janë të përgatitura për tu përballur me pasojat. Barra bie kryesisht mbi e kumatet më të ulëta të Indeksit Socio-demografik (SDI) (21). Studimi i barrës globale të SRK tregoi se në disa rajone si Afrika sub-Sahariane, Oqeania, Amerika Latine, barra është shumë më e larta nga sa parashikohej dhe në rajone të tjera si pjesa përqendrore dhe qendrore e Afrikës sub-Sahariane, Azia lindore e jugore, Europa qendrore dhe lindore e Australia është më e ulët nga sa parashikohej. Numri i lartë i të prekurve, impakti negativ i sëmundjes në shëndetin e individëve si dhe barra financiare që kjo sëmundje shkakton duhet të shërbejë si një nxitës për një parandalim dhe trajtim më të mirë.

1.3 Parametrat biologjikë në ndjekjen e të sëmurëve me SRK

Matja e parametrave biologjikë është e rëndësishme jo vetëm në diagnostikimin e pacientëve me sëmundje renale kronike por edhe në monitorimin dhe ndjekjen e tyre (22). Ky monitorim është edhe më i rëndësishëm në pacientët me SRK që ndjekin një dietë hypoproteinike. Diagnoza e SRK vendoset bazuar në rezultatet e testeve laboratorike, ku në pjesën më të madhe të rasteve bëhet vlerësimi i FG si një markues i filtrimit, matja e kreatininës në serum

ose duke përdorur formula të ndryshme për testimin e proteinemis apo albuminemisë (23). Ndërsa parametra të tillë si proteinuria, klirensi i kreatinës, kolesteroli, trigliceridet, kalciumi total, fosfori dhe hemoglobina japin një pasqyrë të gjendjes shëndetësore të pacientit por edhe shërbejnë si parashikues prognostikë të gjendjes shëndetësore. Disa prej tyre sic është proteinuria kanë filluar të përdoret së fundmi edhe si “surrogate” target terapeutik në këta të sëmurë (24). Një studim nga Chen et al. tregoi se proteinuria ishte një parashikues i fortë i riskut për vdekjen renale (24). Studime të shumta kanë treguar se proteinuria është një markues i fortë i progresionit të SRK, dhe gjithashtu shërben si markues edhe për morbiditetin dhe mortalitetin nga sëmundjet kardiovaskulare (24-26). Kjo pasi albuminuria reflekton probleme të filtrimit të albuminës nga glomeruli e që ndiqet më pas nga riabsorbimi nga tubujt.

Klirensi i kreatinës është volumi i plazmës së gjakut të pastruar nga kreatinina për njësi kohe. Është një test i shpejtë dhe kosto-efektiv për monitorimin e funksionit renal dhe i progresionit të dëmtimit të veshkës (27, 28). SRK shoqërohet shpesh me metabolizëm jo normal të lipideve që mund të kontribuojë në dëmtim të funksionit renal i cili mund të çojë në sëmundje dhe vdekje të parakohshme. Dislipidemia në pacientët me SRK shpesh shfaqet në stadet e hershme dhe përkeqësohet progresivisht me progresionin e SRK (29, 30).

Hormoni i paratiroides dhe vitamina D ndihmojnë në rregullimin metabolizmit të kalciumit duke ndikuar në absorbimin dhe eliminimin e tij. Veshkat funksionale shndërron vitaminën D në një hormone aktiv të quajtur kalcitriol që ndihmon në rritjen e absorbimit të kalciumit nga intestinet në gjak. Kështu monitorimi i kalciumit total në pacientët me SRK është tepër i rëndësishëm për mbajtjen e nivelit të këtij elementi në balance (31-33).

Po kështu i nevojshëm dhe i rekomanduar për pacientët me sëmundje renale kronike është edhe monitorimi i niveleve të fosforit. Studimet tregojnë që progresioni i sëmundjes renale është i lidhur ngushtë me akumulimin e fosfatit, kjo pasi veshkat e kanë humbur funksionit e tyre për të eliminuar sasi të tepërta të fosfatit (34-36).

Duke patur parasysh se në pacientët me SRK anemia është një ndër komplikacionet kryesore për shkak të dëmtimit të prodhimit të eritropoetinës nga veshkat, bëhet i nevojshëm edhe monitorimi i hemoglobinës (37, 38).

1.4 Përdorimi i ketoanalogëve në trajtimin e SRK

Veshkat janë organi kryesor që bën degradimin e produkteve të proteinave. SRK karakterizohet nga akumulimi i një numër tretësirash të emëtuara si toksina uremike. Pjesa më e madhe e toksinave uremike janë produkt i degradimit të aminoacideve të marra nëpërmjet dietës nga mikrobiota intestinale dhe përkeqësojnë gjëndjen e pacientëve me SRK (39-42). Duke u bazuar në këto observime, prej më shumë se një shekulli, dieta me përmbajtje të ulët proteine është përdorur për trajtimin e pacientëve me sëmundje renale kronike (43, 44).

Një dietë e varfër në proteina ndihmon në ruajtjen e funksionit renal dhe con në ulje të hiperlipidemisë, proteinemisë, hiperfosfatemisë, dhe presionit të gjakut (45-48). Megjithatë ndjekja e një diete të tillë rrit rrezikun për malnutricion dhe kaheksi. Kështu kombinime të ndryshme të dietës me proteina janë testuar shoqëruar me suplemente analogë të aminoacideve esenciale ose analogë ketoacid të lira nga nitrogjeni (KA). KA janë prekursorë të aminoacideve korresponduese. KA i nënshtrohen një transformimi psh një reaksion kimik që transferon një grup aminik në një ketoacid duke formuar një aminoacid të ri (Figura 1) (39, 42). Këto ketoanalogë të formuar kapin nitrogjenin e tepërt në qarkullim dhe e ripërdorin atë për prodhimin e aminoacideve të reja esenciale. Kështu nëpërmjet kësaj rruge KA kryejnë deaminimin e pjesës më të madhe të aminoacideve (49-52). Ketosteril është një nga KA që përdoret gjerësisht në trajtimin e pacientëve me SRK.




Figura 1. Aminoacid dhe transaminimi i ketoacid analogë të aminoacideve për sintezën e proteinës (burimi: Koppe L et al. 2019)

1.5 Historia e përdorimit të ketoanalogëve në SRK

Walser et al. ishte i pari që përshkroi efektet e një dietë e varfër në proteina dhe me suplementë të ketoanalogëve në 1970 (53). Përgjatë viteve një numër i madh kombinimesh të dietës të varfër në proteina të shoqëruar me ketoanalogë janë testuar duke çuar në rezultate kontradiktore. Një pjesë e madhe e këtyre studimeve kanë treguar se ndjekja e këtij trajtimi ka efekte pozitive metabolike dhe ruan funksionin renal duke ndaluar progresionin e SRK. Dy meta-analiza treguan se një dietë me përmbatje të ulët proteinash (DPUP) e shoqëruar me ketoanalogë ishte efektive në uljen e niveleve të proteinurisë, sklerozës glomerulare dhe fibrozës renale (54, 55).

Gjithashtu pacientë me SRK që ndjekin këtë regjim patën parametra më të mirë metabolikë, në vecanti në acidozë, rezistencën insulinike, metabolizmin kockor, presionin e gjakut pa alterime të statusit nutricional (39, 56-60). Rezultatet e një studimi të kontrolluar rastesor me 207 pacientë tregoi se një dietë me përmbatje shumë të ulët proteinash (0.3 g/kg peshë/ditë) e shoqëruar me KA vonoi kohën e fillimit të dializës për këta pacientë, krahasuar me pacientët që ndoqën një dietë vetëm me një sasi të vogël proteinash (0.6 g/kg peshë/ditë) (61).

Studime të tjera treguan se një dietë e varfër në proteina, me suplemente të KA uli riskun e dializës dhe vdekshmërisë në pacientë më anemi dhe SRK të avancuar (62-65).

Në kontrast me rezultatet e mësipërme, studime të tjera nuk treguan diferencë në ruajtjen e funksionit renal ndërmjet grupit që mori një dietë të varfër në proteina të shoqëruar me suplemente të ketosteril, krahasuar me grupe të tjera që ndoqën një dietë pa suplemente të ketoanalogëve (66, 67). Në këtë background ku rezultatet e studimeve të ndryshme janë kontraversale mbi benefitet e suplemente të ketoanalogëve ose sic quhet ndryshe ketodiet është i nevojshëm hulumtimi i mëtejshëm i efektit të kësaj dietë në pacientët me SRK (68). Për më tepër, në njohuritë tona më të mira nuk ka ende një studim të botuar mbi efektet e ketosteril në pacientët me SRK në Shqipëri duke patur parasysh që ketosteril është një medikament që subvencionohet nga Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor.

2. QËLLIMI I STUDIMIT

Qëllimi i studimit është vlerësimi i efikasitetit të dietës me përmbajtje të vogël proteinash dhe e shoqëruar me suplemente keto-aminoacide në funksionin dhe morfologjinë renale si dhe në parandalimin e progresionit të sëmundjes renale kronike stadi 3 dhe 4.

3. OBJEKTIVAT SPECIFIKË

1. Identifikimi i karakteristikave sociodemografike të tre grupeve të marra në studim.
2. Investigimi i parametrave kliniko laboratorike: indeksi i masës trupore (BMI), niveli i proteinurisë, proteinemia, klirensi i kreatininës, kolesteroli, trigliceridet (TG), Kalciumi total (Ca total), Fosfori, Hemoglobina (Hb) për të tre grupet në baseline ose para fillimit të trajtimit.
3. Vlerësimi i parametrave kliniko-laboratorike duke përfshirë: diagnoza, diagnoza shoqeruese, trajtimi, BMI, niveli i proteinurisë, proteinemia, klirensi i kreatininës, kolesteroli, trigliceridet, Kalciumi total, Fosfori, Hemoglobina (Hb) pas 3 muajsh, pas 6 muajsh, pas 9 muajsh dhe pas 12 muajsh në të tre grupet e studimit.
4. Krahasimi i parametrave kliniko-laboratorike (BMI, niveli i proteinurisë, proteinemia, klirensi i kreatininës, kolesteroli, trigliceridet, Kalciumi total, Fosfori, Hb) pas 3 muajsh, pas 6 muajsh, pas 9 muajsh dhe pas 12 muajsh e grupit të kontrollit me dy grupet e treja te marra në studim.

4. METODOLOGJIA

4.1 Tipi i studimit

Studimi është klinik, prospektiv.

4.2 Popullata në studim

Gjithsej në studim janë përfshirë 120 pacientë të ndarë në 3 grupe:

1. grupi I, pacientët do të marrin një dietë me përmbajtje shumë të ulët proteinash (0.6 g/kg) të shoqëruara me suplemente keto-aminoacideve (DPSUP-KA)
2. grupi II, pacientët do të marrin një dietë përmbajtje të ulët proteine të shoqëruar me suplemente të keto-aminoacideve (0.8 g/kg) (DPUP-KA)
3. grupi III pacientët do të marrin një dietë me përmbajtje relativisht të ulët proteine (1.2 g/kg) (DPUP)

Kriteret e përfshirjes

Pacientët me sëmundje kronike renale si piolonefriti, glomerulonefritet akute, nefritet intersteciale, hipertensioni (HTA) sekondar në stadin 3 dhe 4 ($15\text{ml}/\text{min}/1.73\text{m}^2 < \text{GFR} < 45\text{ ml}/\text{min}/1.73\text{m}^2$, të përlogaritura me formulën Cockcroft-Gault. Të sëmuret duhet të kishin regjim dietik hipoprotetistik minimumi 0.6 gr-1.2 gr kg/peshë marrje orale me ushqim pa shtesa të tjera proteinike.

Kriteret e përjashtimit:

- Pacientët e diagnostikuar me diabet mellitus
- Pacientët e pamundshëm për të ndjekur studimin nëpërmjet kontrollit të dietës
- Pacientët me vlerë të FG < 15 ml/min/1.73m²
- Pacientët me hiperkalcemi ose hiperkalemi (> normale ose mbi normë);
- Pacientët me sëmundje të tjera rënda si p.sh. të zemrës, mushkërisë, trurit gjatë tre muajve të fundit
- Pacientët me insuficiencë kardiake NYHA IV
- Pacientët me pacientët me cirrozë hepatike ALT ose AST mbi dyfishin e normës
- Pacientët që kanë abuzuar me medikamentet
- Pacientët e diagnostikuar me tumor malinj
- Pacientët që kanë marrë trajtim për një kohë të gjatë me imunosupresor (si.psh. Cyclophosphamidum, Cyclosporine, Prograf, Azathioprine).
- Pacientët gra që planifikojnë shtatzani gjatë periudhës së studimit.
- Pacientët që marrin pjesë në studimet të tjera klinike deri në 30 ditë përpara këtij studimi.

4.3 Mbledhja e të dhënave

Subjektet u rekrutuan nga pavioni i nefrologjisë në Spitalin Rajonal Durrës dhe u ndoqën për një periudhë 2 vjecare. Mbledhja e të dhënave u krye duke u bazuar në kartelën klinike të pacientëve të përfshirë në studim, administrimin e një pyetësoi dhe monitorimi i parametrave kliniko-laboratorik. Matjet e parametrave biologjikë si BMI, proteinuria 24 orëshe, proteinemia, klirensi i kreatininës, kolesterolit, TG, Ca total, fosforemia dhe Hb, u regjistruan para fillimit të trajtimit, pas 3 muajsh, pas 6 muajsh, pas 9 muajsh, dhe pas 12 muajsh. Të dhënat u mblodhën duke nëpërmjet një skede të paraqitur më poshtë.

Skeda e studimit

Skeda Nr. _____

Nr. Identifikimit _____ Grupi i studimit _____ Muaji _____ Data _____

Të dhëna të përgjithshme

Spitali/Pavioni/Dhoma _____

Pacienti _____

Nr. i kartelës klinike _____

Mosha _____

Gjinia _____

Pesha (kg) _____ Gjatësia (m) _____ BMI _____

Të dhëna klinike

Të dhënat laboratorike

Proteinuria 24 orëshe _____

Proteinemia _____

Klirensi i kreatininës _____

Kolesteroli _____

Trigliceridet _____

Kalcium total _____

Fosforemia _____

Hemoglobina _____

Modalitetet e trajtimit

1. Dietë me përmbajtje shumë të ulët proteinash (0.6 g/kg/peshë/ditë) shoqëruar me ketoanalogë
2. Dietë me përmbajtje të ulët proteinash (0.8 g/kg/peshë/ditë) shoqëruar me ketoanalogë
3. Dietë me përmbajtje relativisht të ulët proteinash (1.2 g/kg/peshë/ditë)

Për secilin nga variablat e marrë në studim u bë edhe përcaktimi dhe kategorizimi.

Përkufizimi dhe kategorizimi i variablave të studimit paraqitet në Tabelën Nr. 1.

Tabela 3. Përkufizimet për variablat e marrë në studim

Variabli	Përkufizimi	Lloji
Grupi i studimit	I ndarë në 3 grupe bazuar në dozën marrjen së proteinave dhe ketosterilit: 1. Dietë me përmbajtje shumë të ulët proteinash (0.6 g/kg/peshë/ditë) shoqëruar me ketoanalogë 2. Dietë me përmbajtje të ulët proteinash (0.8 g/kg/peshë/ditë) shoqëruar me ketoanalogë 3. Dietë me përmbajtje relativisht të ulët proteinash (1.2 g/kg/peshë/ditë)	kategorik
Gjinia	Përcaktuar në mashkull ose femër sipas thë dhënave në kartën e identitetit (ID)	Kategorik dikotomik
Mosha	Mosha sipas vitit të lindjes në ID	numerik
Diagnoza kryesore	Diagnoza sipas përcaktimit në kartelën e pacientit	Nominal
Diagnoza shoqëruese e dytë	Diagnoza sipas përcaktimit në kartelën e pacientit	Nominal
Diagnoza shoqëruese e tretë	Diagnoza sipas përcaktimit në kartelën e pacientit	Nominal
Mjekimi me antihipertensivë	Mjekim me antihipertensive të përfshirë në kartelën e pacientit I kategorizuar në 2 kategori Po/Jo	dikotomik
Mjekimi për aneminë	Mjekim për aneminë të përfshirë në kartelën e pacientit I kategorizuar në 2 kategori Po/Jo	dikotomik
Mjekimi me	Mjekim me bikarbonate të përfshirë në kartelën e	dikotomik

bicarbonate	pacientit I kategorizuar në 2 kategori Po/Jo	
Body Mass Index (BMI) tregues i masës trupore	llogaritet me formulën peshe (kg)/gjatësi 2 (m). Peshë trupore është matur më peshore, pa kepuce dhe pa xhupa. TIP për çdo shifër më shumë së 0.5 kg rrumbullakimi në numrin pasardhës dhe nën≤0.5 në numrin para ardhës. Dhe gjatësia me metër në mur pa këpucë.	Numerik I vazhdueshëm
Proteinuria	Niveli i proteinës (mg/24h) në urinë i matur në 3 periudha të caktuara kohore. (Aparatura Respons910)	I vazhdueshëm
Proteinemia	Niveli i proteinës në gjak (g/dL) i matur në serum (Aparatura Respons910)	I vazhdueshëm
Klirensi i kreatininës	Që të caktohet klirensi i kreatininës duhet të grumbullohet diureza 24 orëshe si dhe matet kreatinina në serum dhe llogaritet në bazë të formulës: $Cl_{cr} = (Ucr \times Su) / Scr$ (Cl_{cr} =klirensi i kreatininës ml/min, Ucr=koncentrimi urinar i urinës mmol/l, Su-sasia e urinës për 24 orë, Scr-kreatinina në serum mmol/l) (69)	I vazhdueshëm
Kolesterolemia	Matja e kolesterolit në gjak (mg/dL)u krye në 0,5 ml serum të heparinizuar me metodat spektrofotometrike (70)	I vazhdueshëm
Trigliceridemia	Matja e triglicerideve (mg/dL) në gjak u krye në 0,5 ml serum të heparinizuar me metodat spektrofotometrike (2)	I vazhdueshëm
Kalcemia	Matja e kalciumit total u bë në 0.5 ml serum të heparinizuar (mg/dl)me metoda spektrofotometrike	I vazhdueshëm
Fosforemia	Matja e fosforit u bë në 0.5 ml serum (mg/dl)	I vazhdueshëm
Hemoglobina	Matja e Hb u bë në gjak komplet me KEDTA (g/dl)	I vazhdueshëm

4.4 Analiza statistikore

Të dhënat u mblodhën nëpërmjet skedave të cilat më pas u hodhën dhe sistemuan në programin kompjuterik Excel ku edhe u përgatitën për analizën statistikore. Vlerat e $P \leq 0.05$ u konsideruan sinjifikative (domethënëse). Analiza statistikore u krye nëpërmjet paketës statistikore për shkencat sociale, version 26 (IBM SPSS: Statistical Package for Social Sciences 26) dhe programit statistikor R 4.1.1.

- Statistikat përmbledhëse për të gjithë popullatën dhe secilin grup në studim u paraqitën duke përdorur numër dhe përqindje për variablat kategorikë dhe medianën dhe deviacionin standard për variablat e vazhueshëm para fillimit të trajtimit.
- Analiza bivariate u realizua për të parë diferencat ndërmjet grupeve para fillimit të trajtimit duke përdorur testin Hi katror ose testin ekzakt të Fisher për variablat kategorikë dhe One Way ANOVA ose testin Kruskal Wallis për variablat e vazhdueshëm.
- Për të vlerësuar nëse diferenca ndërmjet matjeve të përsëritura të variablave si: BMI, proteinuria, proteinemia, klirensi i kreatininës, kolesterolemia, trigliceridemia, kalcemia, fosforemia dhe hemoglobina, është sinjifikante (domethënëse) u krye testi i Repeated Measures of ANOVA- Matjet e përsëritura ANOVA.
- Analiza post hoc duke përdorur testin Tukey u përdor për të vlerësuar ndryshimit midis 3 mujorëve po ashtu dhe ndryshimet midis 3 grupeve.
- Duke marrë parasysh se vetëm dy subjekte të studimit patën progresion negativ drejt hemodializës, analiza e mbijetesës me Kurbën Kaplan-Meier nuk u pa e nevojshme.

5. REZULTATET

5.1 Analizimi i të dhënave të përgjithshme

Në studim morën pjesë 120 pacientë, nga të cilët 45 subjekte ndoqën një dietë me përmbajtje shumë të ulët proteinash (0.6 g/kg/peshë/ditë) shoqëruar me ketoanalogë - pjesë e grupit I; 50 subjekte ndoqën një dietë me përmbajtje proteine 0.8 g/kg/peshë/ditë, të shoqëruar me suplemente të keto-aminoacideve - pjesë e grupit II, dhe 25 subjekte ndoqën një dietë me përmbajtje relativisht të ulët proteinash (1.2 g/kg/peshë/ditë) - pjesë e grupit III. Të dhënat e përgjithshme për popullatën në total dhe për secilin grup në vecanti janë paraqitur në Tabelën Nr. 4.

Tabela 4. Të dhënat e përgjithshme të subjekteve në total dhe sipas grupeve

Variablat	Total	Grupi I	Grupi II	Grupi III	p value
	n(%) n=120	N (%) n=45 (37.5)	N (%) n=50(41.7)	N (%) n=25(20.8)	
Sociodemografikë					
Gjinia					0.110 [#]
Femër n(%)	74 (61.6)	23 (51.1)	32 (64.0)	19 (76.0)	
Mashkull n(%)	46 (38.3)	22 (48.9)	18(36.0)	6(24.0)	
Mosha, vite mediana (SD)	61.4 (8.52)	60.0(7.63)	62.4(10.2)	61.7(6.03)	0.409*


BMI mediana (SD)	23.7 (1.8)	23.6(2.26)	24.0(1.60)	23.5(1.23)	0.411*
Sëmundje bashkëshoqëruese 1					0.0163 [#]
HTA n(%)	59 (49.2)	22(48.9)	18(36.0)	19(76)	
PNK n(%)	57 (47.5)	21 (46.7)	30 (6.0)	6 (24.0)	
Asnjë n(%)	4 (3.3)	2 (4.4)	2 (4.0)	0 (0.0)	
Sëmundje bashkëshoqëruese 2					0.011 [#]
HTA n(%)	7 (5.8)	7 (15.6)	0 (0.0)	0 (0.0)	
Anemia n(%)	76 (63.3)	28 (62.2)	32(64.0)	16 (64.0)	
Dislipidemia n(%)	1 (0.8)	1 (2.2)	0 (0.0)	0 (0.0)	
Asnjë n(%)	36 (30)	9 (20)	18(36.0)	9(36.0)	

testi Ekzakt i Fisherit, *One Way ANOVA

Mosha mesatare e pacientëve të përfshirë në studim është 61.3 vjeç, (Tabela 1.) dhe specifikisht mosha mesatare për Grupin I është 60.0 (7.63); Grupin e II 62.4 (10.2); Grupin III 61.7 (6.03). Megjithatë nuk konstatuam një dallim statistikisht sinjifikativ të moshës në tre grupet krahasuese (One-Way analysis of means (not assuming equal variances) $F = 0.90399$, num df = 2.000, denom df = 71.587, p-value = 0.4095).

Në Figurën 2 paraqitet mosha mesatare sipas grupeve në studim.


Figura 2. Mosha mesatare sipas grupeve në studim.



Pjesa më e madhe e pacientëve në studim janë femra 74 (61.6) vs 46 (38.4) meshkuj.

Grupi III ka dhe përqindjen më të lartë të femrave (76%) dhe grupi II ka përqindjen më të ulët të femrave (51.1%). Por sipas testit Hi katror nuk ka ndryshime statistikisht sinjifikante ndërmjet 3 grupeve (Testi hi katror -X-squared = 4.4089, df = 2, p-value = 0.1103).

Figura 3. Shpërndarja e pacientëve sipas gjinisë dhe grupeve



Përsa i përket sëmundjeve bashkëshoqëruese të SRK, vumë re se pothuajse të gjithë pacientët kishin të paktën një sëmundje bashkëshoqëruese. Pjesa më e madhe e subjekteve të studimit kishin si sëmundje të pare bashkëshoqëruese HTA (49.2%), pielonefrit kronik (PNK) (47.5%) dhe sëmundje e dytë bashkëshoqëruese anemi (63.3%).

Tabela 5. Parametrat kliniko-laboratorikë para fillimit të studimit

Variablat	Total	Grupi I	Grupi II	Grupi III	p value
	n(%) n=120	n(%) n=45 (37.5)	n(%) n=50(41.7)	n(%) n=25(20.8)	
Parametrat laboratorike para trajtimit					
BMI	23.7 (1.8)	23.6(2.26)	24.0(1.60)	23.5(1.23)	0.410*
Proteinuria 24 h	1.07(0.6)	1.01(0.59)	1.12(0.6)	1.08(0.37)	0.636*
Proteinemia	5.63 (0.6)	5.51(0.4)	5.83(0.8)	5.52(0.4)	0.321 [#]
Klirensi i kreatininës	40.4(4.43)	40.5(6.1)	40.5(3.4)	39.9(2.5)	0.113 [#]
Kolesteroli	261 (35.2)	264(39.9)	255(33.5)	268(28.3)	0.279*
Trigliceridet	173 (38.2)	182(49.7)	167(30.7)	167(24.7)	0.141*
Kalciumi total	7.63 (0.45)	7.62(0.5)	7.58(0.5)	7.73(0.4)	0.335 [#]
Fosforemia	3.93 (1.05)	3.8(0.8)	4.21(1.4)	3.84(0.6)	0.077 [#]
Hemoglobina	9.95(0.94)	9.98 (0.6)	9.99(1.1)	9.82(1.1)	0.117 [#]

*One Way ANOVA, #Krusal Wallis

Tabela 2 paraqet parametrat laboratorike të subjekteve para fillimit të studimit. Për krahasimin e mesatareve midis grupeve u përdor testi i One Way ANOVA në rastet kur të dhënat kishin një shpërndarje normale dhe testi jo parametrik i Kruskal Ëallis kur të dhënat nuk kishin një shpërndarje normale. Ashtu si vërehet nga vlera e p, për asnjë nga parametrat laboratorikë nuk ka ndryshim sinjifikativ të tre grupeve të marrë në studim. Më poshtë gjenden tabelat e rezultateve të testit One Way ANOVA për disa nga parametrat laboratorikë.

Tabela 6. Rezultatet e testit One-Way ANOVA për BMI para fillimit të trajtimit

BMI-One Way ANOVA					
	Df	Sum Sq	Mean Sq	F value	Pr (>F)
Grupet	2	6	2.983	0.902	0.409
Residuals	117	387.1	3.308		

Sipas rezultateve të tabelës para fillimit të trajtimit nuk kishte diferenca statistikisht sinjifikante të BMI midis 3 grupeve krahasuese.

Tabela 7. Rezultatet e testit One-Way ANOVA për proteinurinë 24h para fillimit të trajtimit

Proteinuria 24h-One Way ANOVA					
	Df	Sum Sq	Mean Sq	F value	Pr (>F)
Grupet	2	0.29	0.1429	0.455	0.636
Residuals	117	36.79	0.3144		

Rezultatet e testit ANOVA nuk tregojnë për ndryshime sinjifikante të proteinurisë 24 orëshe në periudhën kohore të para fillimit të trajtimit.

Tabela 8. Rezultatet e testit One-Way ANOVA për Kolesterolin para fillimit të trajtimit

Kolesterolit-One Way ANOVA					
	Df	Sum Sq	Mean Sq	F value	Pr (>F)
Grupet	2	3181	1591	1.291	0.279
Residuals	117	144195	1232		

Referuar tabelës së mësipërme ne nuk konstatuam ndryshime sinjifikante në nivelet mesatare të kolesterolit në të treja grupet para fillimit të trajtimit.

Tabela 9. Rezultatet e testit One-Way ANOVA për TG para fillimit të trajtimit

Trigliceridet-One Way ANOVA					
	Df	Sum Sq	Mean Sq	F value	Pr (>F)
Grupet	2	5715	2857	1.989	0.141
Residuals	117	168069	1436		

Sipas rezultateve në tabelën e mësipërme nuk u konstatua ndryshim statistikisht sinjifikant në nivelin e TG në të treja grupet në periudhën para fillimit të trajtimit.

5.2 Analizimi i matjeve të përsëritura të parametrave laboratorikë

Për të vlerësuar ndryshimet e parametrave laboratorikë përgjatë tre mujorëve të ndryshëm si brenda grupit po ashtu dhe për të krahasuar këto ndryshime ndërmjet 3 grupeve në studim, ne përdorëm testin e Repeated Measures ANOVA duke proceduar me një model linear general

për matje të përsëritura. Duke patur parasysh se në të gjithë parametrat laboratorikë të matur, kriteret e sfericitetit (Mauchlys test) dhe i variancave homogjene (Levene test) nuk u përmbushën pasi rezultatet e të dy testeve ishin statistikisht sinjifikante, për të interpretuar rezultatet e testeve iu referuam vlerat e Pillai`s Trace.

Ndryshimet në BMI përgjatë tremujorëve dhe grupeve

Tabela 10. Vlera mesatare e BMI sipas tremujorëve dhe grupeve

Statistika përkruese				
	Grupet	Mesatarja	Deviacioni Standart	N
BMI Para trajtimit	Gr 1	23.556	2.2619	45
	Gr 2	23.970	1.6009	50
	Gr 3	23.464	1.2315	25
	Total	23.709	1.8174	120
BMI Pas 3 muaj	Gr 1	23.422	2.2410	45
	Gr 2	23.946	1.5902	50
	Gr 3	23.440	1.2275	25
	Total	23.644	1.8077	120
BMI Pas 6 muaj	Gr 1	23.267	2.1149	45
	Gr 2	23.910	1.5559	50
	Gr 3	23.392	1.2376	25
	Total	23.561	1.7463	120
BMI pas 9 muaj	Gr 1	22.744	1.8848	45
	Gr 2	23.738	1.5845	50

	Gr 3	23.260	1.3429	25
	Total	23.266	1.7051	120
BMI pas 12 muaj	Gr 1	22.411	1.8224	45
	Gr 2	23.085	3.6990	50
	Gr 3	23.160	1.3595	25
	Total	22.847	2.7113	120

Bazuar në të statistikave përshkruese kemi rënie të lehtë vlerës mesatare të BMI përgjatë vitit në të treja grupet.

Tabela 11. Efekti i kohës dhe grupit në ndryshimet e BMI

Teste multivariate							
Efekti		Vlera	F	Hypothesis df	Error df	Sig.	Partial Eta Squared
Koha	Pillai's Trace	.329	13.943 ^b	4.000	114.000	.000	.329
	Wilks' Lambda	.671	13.943 ^b	4.000	114.000	.000	.329
	Hotelling's Trace	.489	13.943 ^b	4.000	114.000	.000	.329
	Roy's Largest Root	.489	13.943 ^b	4.000	114.000	.000	.329
Koha * Grupet	Pillai's Trace	.207	3.315	8.000	230.000	.001	.103
	Wilks' Lambda	.795	3.461 ^b	8.000	228.000	.001	.108
	Hotelling's Trace	.255	3.606	8.000	226.000	.001	.113
	Roy's Largest Root	.246	7.059 ^c	4.000	115.000	.000	.197

a. Design: Intercept + Grupet Within Subjects Design: time

Për të parë nëse rënia e vlerës mesatare të BMI përgjatë tremujorëve iu referuam vlerës së Pillai's Trace. Bazuar në këto vlera, ne konstatuam se brenda grupit ndryshimet në kohë ishin statistikiisht sinjifikante ($p < 0.001$) dhe po ashtu kemi një ndërveprim (interaction) midis kohës dhe grupeve ($p = 0.001$).

Duke patur parasysh se kemi një ndërveprim ndërmjet kohës dhe grupeve ne nuk mund të flasim për efektin e secilit faktor vecmas. Prandaj realizuam një analizë post hoc shoqëruar me korigjime për krahasime të shumëfishta (metoda Bonferroni) për të krahasuar ndryshimet e vlerave të BMI brenda grupit dhe ndërmjet grupeve.

Tabela 12. Krahasimet të shumëfishta mbi ndryshimet e BMI sipas grupeve

Krahasime të shumëfishta							
Koha	(I) Grupet	(J) Grupet	Diferenca e mesatareve (I-J)	Std. Error	Sig. ^b	95% Intervali i konfidencës për diferencën	
						Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
1	Gr 1	Gr 2	-.414	.374	.809	-1.322	.493
		Gr 3	.092	.454	1.000	-1.010	1.194
	Gr 2	Gr 1	.414	.374	.809	-.493	1.322
		Gr 3	.506	.446	.775	-.576	1.588
	Gr 3	Gr 1	-.092	.454	1.000	-1.194	1.010
		Gr 2	-.506	.446	.775	-1.588	.576

2	Gr 1	Gr 2	-.524	.371	.481	-1.424	.377
		Gr 3	-.018	.450	1.000	-1.111	1.076
	Gr 2	Gr 1	.524	.371	.481	-.377	1.424
		Gr 3	.506	.442	.764	-.568	1.580
	Gr 3	Gr 1	.018	.450	1.000	-1.076	1.111
		Gr 2	-.506	.442	.764	-1.580	.568
3	Gr 1	Gr 2	-.643	.357	.221	-1.509	.223
		Gr 3	-.125	.433	1.000	-1.177	.926
	Gr 2	Gr 1	.643	.357	.221	-.223	1.509
		Gr 3	.518	.425	.676	-.514	1.550
	Gr 3	Gr 1	.125	.433	1.000	-.926	1.177
		Gr 2	-.518	.425	.676	-1.550	.514
4	Gr 1	Gr 2	-.994*	.341	.013	-1.822	-.165
		Gr 3	-.516	.414	.647	-1.522	.491
	Gr 2	Gr 1	.994*	.341	.013	.165	1.822
		Gr 3	.478	.407	.727	-.510	1.466
	Gr 3	Gr 1	.516	.414	.647	-.491	1.522
		Gr 2	-.478	.407	.727	-1.466	.510
5	Gr 1	Gr 2	-.674	.557	.687	-2.028	.680
		Gr 3	-.749	.677	.812	-2.392	.895
	Gr 2	Gr 1	.674	.557	.687	-.680	2.028
		Gr 3	-.075	.664	1.000	-1.689	1.539
	Gr 3	Gr 1	.749	.677	.812	-.895	2.392
		Gr 2	.075	.664	1.000	-1.539	1.689
Based on estimated marginal means							
*. The mean difference is significant at the .05 level.							
b. Korigjime per krahasime te shumefishta: Bonferroni.							

